REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK

**KOMISIONI I FINANCAVE, BUXHETIT DHE ASETEVE PUBLIKE**

RAPORT VENDIMARRJE

Nr 17, Datë 17/ 10/ 2025

Lënda: Vendim për shqyrtimin e projekt-vendimit nr........datë, ........./........./2025, *"Për miratimin e përdorimit të një pjesë të fondit të Emergjencave Civile dhe kalimin e tij Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale"*

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Elbasan

Hyrje

Ky projekt-vendim paraqitet nga *Drejroria e Pergjithshme e politikave te Zhvillimit Urban he Sherbimeve Infrastrukturore dhe Drejoria e Mbrojtjes Civile,* dhe ka për qëllim:

| | |
|---|---|
| BAZUESHMERIA LIGJORE DHE VOTIMI | *Bashkia Elbasan ka lidhur tre marrëveshje për kryerjen e operacioneve xhenier për montimin e urave metalike tip "Bailey" me repartin ushtarak nr. 4040, në të cilën përcaktohen qartësisht detyrimet e palëve në marrëveshje, me vendndodhje në fshatin Papër Sallak, Njësia Administrative Papër; fshati Papër (Lgj. Matrej), Njësia Administrative Papër si edhe në përroin e Gostimës, fshati Polis, Njësia Administrative Shushicë. Këto marrëveshje janë lidhur në muajin Tetor 2025 ndërmjet këtyre dy institucioneve dhe organi që duhet ta zbatojë atë është Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale, e cila është përcaktuar me Urdhër Administrativ nga Kryetari i Bashkisë nr. 828 datë 9.10.2025. Duke qenë se Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale nuk e ka parashikuar në buxhetin e vitit 2025 financimin e përfundimit të këtyre objekteve, ajo nuk mund të përmbushë plotësisht detyrimet pa një shtesë buxheti. Kjo shtesë është e domosdoshme, pasi urat aktualisht janë të papërfunduara duke qenë se nuk kanë pjesën e sipërme kaluese e në këtë mënyrë nuk mund të shfrytëzohen. Nëse mbeten vetëm me këmbët e urës dhe speronave të saj ajo është një rrezik serioz, pasi këmbësorët nuk mund të kalojnë aty por do të vazhdojnë të kalojnë përmes përrenjve. Për më tepër, ky investim është i domosdoshëm dhe emergjent për të siguruar kalueshmërinë nga njëra anë e përroit në anën tjetër, të garantojë sigurinë e lëvizjes së banorëve dhe të nxënësve, pasi aktualisht ata kalojnë mes përroit të Gorres (devijim i përroit të Paprit), përroit të Gurrës me mjete bujqësore, duke rrezikuar jetën e tyre në kohë me reshje shiu..* |
| SITUATA AKTUALE E FUNKSIONIT | *Duke qenë se këto ura janë të domosdoshme për lëvizjen e banorëve dhe qarkullimin e mjeteve nga njëra anë në tjetrën, për këtë arsye kërkohet edhe përfundimi i këtij objekti. Ky fond do të përdoret për blerjen e materialeve si më poshtë: 1. Lëndë drusore –576,000 (peseqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë; 2. Vida-217,800 (dyqind* |

| | |
|---|---|
| | e shtatëmbëdhjetë mijë etetëqind) lekë 3. Naftë -378,000 (treqind e shtatëdhjetë e tetë mijë) lekë 4. Vajra lubrifikantë – 52,800 (pesëdhjetë e dy mijë e tetëqind) lekë 5. Dieta për 26 specialistë për 22 ditë -1,100,000 (një miljon e njëqind mijë) lekë Duke qenë në këto kushte, Drejtoria e Mbrojtjes Civile do të kryejë kalimin e fondit prej 2,324,600 lekë nga fondi i Mbrojtjes Civile, miratuar nga Këshilli Bashkiak Elbasan me nr. VKB nr. 138 datë 26.12.2024, "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2025, si dhe Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar për periudhën 2025-2027". Bashkëngjitur do të gjeni preventivin e hartuar nga administrata e Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale e cila e ka hartuar këtë preventiv në bazë të tre marrëveshjeve të lidhura me Repartin Ushtarak nr. 4040. |
| SITUATA FINANCIARE (Impakti financiar, shtesa pakësime në buxhet) | Duke qenë se këto ura janë të domosdoshme për lëvizjen e banorëve dhe qarkullimin e mjeteve nga njëra anë në tjetrën, për këtë arsye kërkohet edhe përfundimi i këtij objekti. Ky fond do të përdoret për blerjen e materialeve si më poshtë: 1. Lëndë drusore –576,000 (pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë; 2. Vida-217,800 (dyqind e shtatëmbëdhjetë mijë etetëqind) lekë 3. Naftë -378,000 (treqind e shtatëdhjetë e tetë mijë) lekë 4. Vajra lubrifikantë – 52,800 (pesëdhjetë e dy mijë e tetëqind) lekë 5. Dieta për 26 specialistë për 22 ditë -1,100,000 (një miljon e njëqind mijë) lekë Duke qenë në këto kushte, Drejtoria e Mbrojtjes Civile do të kryejë kalimin e fondit prej 2,324,600 lekë nga fondi i Mbrojtjes Civile, miratuar nga Këshilli Bashkiak Elbasan me nr. VKB nr. 138 datë 26.12.2024, "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2025, si dhe Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar për periudhën 2025-2027". Bashkëngjitur do të gjeni preventivin e hartuar nga administrata e Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale e cila e ka hartuar këtë preventiv në bazë të tre marrëveshjeve të lidhura me Repartin Ushtarak nr. 4040. |
| DREJTORIA PËRGJEGJËSE | Drejroria e Pergjithshme e politikave te Zhvillimit Urban he Sherbimeve Infrastrukturore dhe Drejoria e Mbrojtjes Civile |
| RAPORTIMI DHE MONITORIMI | Zbatimi dhe monitorimi i ketij vendimi do te sigurohet nga Komisioni i Përhershëm i Financave, Keshilli Bashkiak sipas nevojes. |
| IMPAKTI SOCIAL DHE GRUPET QË PREKEN | *Ky vendim ndihmon te gjithe komuitetin qe akseson dhe jeton ke ne keto zona te lidhje me infratrukturen e mesiperme.* |
| KONSULTIMI PUBLIK | *Jo* |

Komisioni i Përhershëm i Financave, Buxhetit dhe Aseteve Publike, i mbledhur më datën 17/ 10/ 2025 pasi shqyrtoi Projekt-vendimin për miratimin e Projekt-vendimit te mesiperm, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij, paraqitur nga Kryetari i Bashkisë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ELBASAN

KESHILLI BASHKIAK

**KOMISIONI I FINANCAVE, BUXHETIT DHE ASETEVE PUBLIKE**

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Ti propozojë Këshillit Bashkiak:

a. Kalimin e projekt aktit në mbledhjen e këshillit për vlerësim të mëtejshëm për vlerësim dhe miratim.

**b. <u>Miratimin e projektaktit</u>**

c. Refuzimin e miratimit të Projektaktit

d. Ti kerkoje drejtorise perkatese informacion shtese per projektvendimin

e. Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:

- Pika ...... e projektvendimit të ndryshojë në "____________"
- Pika ........ e projektvendimit të ndryshojë në"______________"
- Tabela ...... e projektvendimit të ndryhsojë në"____________"
- Paragrafi ......... i projektvendimit të ndryshojë në "_______"

Bashkëlidhur argumentat e Vendimarrjes dhe mendimi i pakicës i parqitur në procesverbalin e Komisionit

| | |
|---|---|
| Kryetari i Komisionit: | Shefqet Bullari |
| Nenkryetar i Komisionit: | Doris Madhi |
| Sekretar i Komisionit: | Erestina Shushku |
| Anetar i Komisionit: | Bukurosh Stafa |
| Anetar i Komisionit: | Ermira Urupi |
| Anetar i Komisionit: | Imelda Sejdini |
| Anetar i Komisionit: | Eugen Isaj |

Elbasan, më: 17/ 10/ 2025